

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë :

Ardian DVORANI - Kryesues
Arjana FULLANI - Anëtar
Andi ÇELIKU - Anëtar

Në datën **01.03.2017** mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen Administrative me **Nr. 31003-04683-2014 akti** që ju përket palëve :

PADITËS: **Pranvera Aliaj**

E PADITUR: **Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës**

OBJEKTI: Shpërblimin në masën pagës së një viti për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës në bazë të nenit 155 të K.Punës, shpërblimin në masën e dy pagave mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit të parashikuar nga neni 143/1 të K.Punës, shpërblimin në masën e dy pagave mujore për mosrespektim të procedurës së parashikuar nga neni 144 në bazë të pikës pesë të K.Punës dhe shpërblimin për vjetërsi në punë në masën e 2 pagave mujore sipas nenit 145 të K.Punës.

BAZA LIGJORE: Nenet 143, 144, 145, 155 të K.Punës.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr.357, datë 03.02.2014 ka vendosur:

Pranimin e padisë.

Detyrimin e të paditur të paguajë paditëses 2 muajve pagë për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Detyrimin e të paditur të paguajë paditëses 1 vit pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar.

Detyrimin e të paditur të paguajë paditëses një javë paga si shpërblim për vjetërsi.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin Nr.2343, datë 10.06.2014 ka vendosur:

Ndryshimin e Vendimit Nr.357, datë 03.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në këtë mënyrë:

Pranimin e pjesëm të padisë.

Detyrimin e palës së paditur që ta dëmshpërblej paditësen me 2 paga mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë si të pabazuara në prova dhe në ligj.

VENDOSI

Prishjen e vendimit Nr.2343, datë 10.06.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit Nr.357, datë 03.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Tiranë, më datë 01.03.2017

**Nr. 31003-04683-00-2014 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-187 i Vendimit (89)**

Dixhitalizuar dhe Perpunuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik
www.infocip.org